



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 1:	RREZIQET NË PUNË
Tema 2.2.	PLUHURI DHE AGJENTËT KIMIKË
Nën-tema 2.2.2.	KANCEROGJENËT DHE MUTAGJENËT NË PUNË
Ligji / rregulloret përkatëse:	• Ligji për kimikate Nr.04/L–197; • Rregullore (MPMS) Nr.04/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet që lidhen me kancerogjenët dhe mutagjenët në punë; • Rregullore (MPMS) Nr.10/2017 për sigurinë dhe mbrojtjen shëndetësore e të punësuarve nga risqet që lidhen me agjentët kimikë në punë; • Rregullore (MPMS) Nr.04/2016 për kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë; • Rregullore (MPMS) Nr.2/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës; • Rregullore (EC) Nr.1907/2006 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 18 dhjetorit 2006 për Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH) dhe krijimin e një Agjencie Evropiane të Kimikateve, duke ndryshuar Direktivën 1999/45/EC dhe duke shfuqizuar Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr.793/93 dhe Rregulloren e Komisionit (CE) Nr.1488/94, si dhe Direktivën e Këshillit 76/769/EEC dhe Direktivat e Komisionit 91/155/EEC, 93/67/EEC, 93/105/EC dhe 2000/21/EC - (REACH); • Rregullore (EC) Nr.1272/2008 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 16 dhjetorit 2008 për klasifikimin, etiketimin dhe paketimin e substancave dhe përzierjeve, e cila ndryshon dhe shfuqizon Direktivat 67/548/EEC dhe 1999/45/EC, dhe ndryshon Rregulloren (EC) Nr.1907/2006 - (CLP); • Rregullore e Komisionit (EU) 2015/830 e datës 28 maj 2015 për ndryshimin e Rregullores (EC) Nr.1907/2006 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (REACH).
Shkurtesa:	• KEP – Klasifikimi, Etiketimi dhe Paketimi • PPM – Pajisje Personale Mbrojtëse • RVAKK – Regjistrimi, Vlerësimi, Autorizimi dhe Kufizimi i Kimikateve • LTS – Lista Teknike e Sigurisë

	● MPMS – Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Përdorimi i listës kontrolluese:	Nëse përgjigjeni “Po” në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni “Jo” bëni vërejtje që mund ta këshilloni punëdhënësin të ndërmarrë veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika kontrolli	Po	Jo	Vërejtje për zbatimin
	PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNËS			
	* Përgatituni për vizitën në lokacion/vendin e punës. Nëse nuk i mbani mend kërkesat tuaja të brendshme, udhëzimet për punën me kancerogjenë dhe mutagjenë (p.sh. kuptimin e piktogrameve në etiketë, kërkesat për etiketim dhe paketim, rregullat), lexojini përsëri dokumentet për të qenë gati për vizitën në lokacion/ vendin e punës. * Verifikoni nëse të gjitha kimikatet me veti kancerogjene dhe/ose mutagjene të përdorura në kompani i kanë Listat Teknike të Sigurisë. * Përgatitni një listë të plotë të kimikateve në kompaninë tuaj dhe informacionin në lidhje me kimikatet: vendndodhjen, sasinë, për ato që përdoren në kompani dhe rreziqet që paraqesin. * Përgatitni një listë të plotë të të punësuarve që përdorin kimikate të veçanta dhe që janë të ekspozuar faktikisht ose potencialisht. Shënim: Lista e kimikateve nuk është e rregulluar në mënyrë strikte, mund ta përshtatni për qëllimet tuaja. Këshillohet të përfshini pikat e mëposhtme: Emri i produktit ose procesit Kimikatet që përmban Numri CAS për secilin nga përbërësit Numri EC Sasia dhe vendndodhja Qëllimi i përdorimit Përdoruesit dhe/ose trajtuesit Informacion mbi rrezikun Detajet e furnizuesit LDS në dispozicion ose jo			
	INSPEKTIMI I LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS			

	* Ju do duhet të mbani shënime gjatë vizitave në vendet e punës. Është më e lehtë të mbani shënime të strukturuar, për shembull, duke përdorur formularët e inspektimit. Merrini me vete. Përmbajtja e formularëve të inspektimit varet nga vendi i punës që do të vizitoni. Nëse nuk keni formularë inspektimi, përgatitni formularë të mirë dhe lehtësisht të kuptueshëm (p.sh. duhet të përfshihet vendi i inspektimit, data/ora, ekipi i inspektimit dhe të punësuarit e inspektuar, lista e substancave dhe përzierjeve kimike që përdoren në kompani, PPM-të që kërkohen për të kryer detyrën/punën, etj.). * Gjatë vizitës në lokacion / vendin e punës kushtoni vëmendje nëse kancerogjenët dhe mutagjenët trajtohen, ruhen dhe deponohen siç duhet. * Inspektoni enët e substancave dhe përzierjeve kancerogjene dhe mutagjene. Sigurohuni që paketimi është etiketuar qartë dhe etiketat janë në gjendje të mirë. Sigurohuni që enët janë të padëmtuara dhe nuk rrjedhin. Vlerësoni nëse substancat ruhen siç duhet. * Vëzhgoni procesin e asgjësimit të mbeturinave dhe sigurohuni që ndiqen procedurat standarde të funksionimit, duke përfshirë përdorimin e enëve të vulosura dhe të etiketuara qartë dhe dukshëm. * Kontrolloni nëse të gjithë të punësuarit: ▪ përdorin PPM të përshtatshme; ▪ nuk pinë, hanë, apo pinë duhan në zonat e punës; ▪ pajisen me veshje mbrojtëse të përshtatshme ose veshje të tjera speciale të përshtatshme; ▪ kanë vende të ndara për ruajtjen e rrobave të punës apo rrobave mbrojtëse dhe atyre normale; ▪ aftësohen për procedurat emergjente. * Kontrolloni nëse zonat ku të punësuarit punojnë me kancerogjenë dhe/ose mutagjenë janë të përcaktuara siç duhet. * Ju duhet të siguroheni që të ofrohen ambiente të përshtatshme dhe adekuate të largës dhe tualetit për punëtorët. * Bëhuni vetë shembull, përdorni PPM-të dhe respektoni rregullat e sigurisë kur keni të bëni me substanca të rrezikshme dhe rreziqe të tjera që ekzistojnë në lokacion / vendet e punës.			
--	--	--	--	--

	* Merrni shënime të vendeve të vëzhguara të punës duke plotësuar formularët e inspektimit dhe bëni fotografi të vendeve ku përdoren dhe/ose ruhen kancerogjenët dhe mutagjenët. Kushtojini vëmendje shembujve të mirë dhe jo të mirë. * Bisedoni me të punësuarit, tregohuni miqësorë, shpjegoni dhe këshillojini ata për rregullat e përgjithshme të sigurisë në punë me kancerogjenët dhe mutagjenët. * Përfundoni inspektimin duke ofruar rekomandime përfundimtare për sigurinë dhe fushat për përmirësim.													
1.	A përfshin detyra e punës përdorimin e substancave kancerogjene ose mutagjene? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 2, 3 <u>Klasifikimi dhe etiketimi i substancave kancerogjene</u> sipas rregullores KEP <table><tr><td>Klasifikimi</td><td>Kategoria 1 (Kategoria 1A, 1B)</td></tr><tr><td>Piktogramet GHS</td><td></td></tr><tr><td>Fjala e sinjalit</td><td>Rrezik</td></tr><tr><td>Deklarata e rrezikut</td><td>H350: Mund të shkaktojë kancer (deklaroni rrugën e ekspozimit nëse vërtetohet përfundimisht se asnjë rrugë tjetër e ekspozimit nuk shkakton rrezik)</td></tr></table> <u>Klasifikimi dhe etiketimi i substancave mutagjene</u> sipas rregullores KEP <table><tr><td>Klasifikimi</td><td>Kategoria 1 (Kategoria 1A, 1B)</td></tr></table>	Klasifikimi	Kategoria 1 (Kategoria 1A, 1B)	Piktogramet GHS		Fjala e sinjalit	Rrezik	Deklarata e rrezikut	H350: Mund të shkaktojë kancer (deklaroni rrugën e ekspozimit nëse vërtetohet përfundimisht se asnjë rrugë tjetër e ekspozimit nuk shkakton rrezik)	Klasifikimi	Kategoria 1 (Kategoria 1A, 1B)			
Klasifikimi	Kategoria 1 (Kategoria 1A, 1B)													
Piktogramet GHS														
Fjala e sinjalit	Rrezik													
Deklarata e rrezikut	H350: Mund të shkaktojë kancer (deklaroni rrugën e ekspozimit nëse vërtetohet përfundimisht se asnjë rrugë tjetër e ekspozimit nuk shkakton rrezik)													
Klasifikimi	Kategoria 1 (Kategoria 1A, 1B)													

Piktogramet GHS				
Fjala e sinjalit	Rrezik			
Deklarata e rrezikut	H340: Mund të shkaktojë defekte gjenetike (deklaroni rrugën e ekspozimit nëse vërtetohet përfundimisht se asnjë rrugë tjetër e ekspozimit nuk shkakton rrezik)			
* Nëse etiketa në paketim tregon piktogramin “Rrezik serioz për shëndetin”, duhet të shihni dokumentin e të dhënave për sigurinë e produktit (LTS) për të sqaruar nëse produkti është kancerogjen dhe/ose mutagjen. * Produkti është kancerogjen dhe/ose mutagjen vetëm kur në seksionin 2 të LTS paraqiten deklaratat e rrezikut H350 dhe/ose H340. Nëse jo, produkti nuk është kancerogjen dhe/ose mutagjen. * Ju duhet të përgatisni listën e kimikateve të rrezikshme të përdorura në kompani (versioni elektronik), përdorni informacionin nga LTS. * Kontrolloni nëse ka kimikate me deklarata të rrezikut H350 dhe H340. Shënoni përgjigjen “po” ose “jo” në kolonat në të djathtë të këtij teksti. * Kontrolloni listën e substancave, përzierjeve dhe proceseve (Rregullorja (MPMS) Nr.04/2017: Shtojca I) e dhënë më poshtë , shënoni me përgjigjen “po” për ato që janë në përdorim në kompani: ○ Prodhimi i auraminës; ○ Puna që përfshin ekspozimin ndaj hidrokarbureve aromatike policiklike të pranishme në blazën e qymyrit, katranin e qymyrit ose ziftin e qymyrit; ○ Puna që përfshin ekspozimin ndaj pluhurit, tymrave dhe sprajeve të prodhuara gjatë pjekjes dhe elektro-rafinimit të bakër-nikelit të papërpunuar; ○ Procesi me acid të fortë në prodhimin e alkoolit izopropilik; ○ Puna që përfshin ekspozimin ndaj pluhurave të drurit të fortë, të tilla si lisi ose ahu¹; ○ Puna që përfshin ekspozimin ndaj pluhurit të respirueshëm të silicor kristaline që gjenerohet nga një proces pune.				

	<i>Në rast se merrni shtatë përgjigje negative, duhet të ktheheni në këtë listë kontrolluese kur futen kimikate të reja ose proces i ri teknologjik në kompani. Nëse ka të paktën një përgjigje pozitive, ju lutemi vazhdoni me pyetjen tjetër.</i>			
2.	A janë etiketuar qartë enët e kimikateve kancerogjene dhe/ose mutagjene (a kanë etiketat emrin e substancave ose përzierjeve kimike ose emrin tregtar, piktogram(e) të rrezikut, deklaratat e riskut dhe të sigurisë)? Nëse kimikatet janë etiketuara si të rrezikshme, a janë piktogramet në etiketa në pajtim me legjislacionin? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 6.5.12, 6.5.13 Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Nenet 6.2.7, 10.1.2 Ligji Nr.04/L-197 për kimikatet, Neni 27 <i>* Vizitoni të gjitha vendet e punës ku përdoren kimikatet me kancerogjenë dhe mutagjenë; kushtojini vëmendje etiketave. Verifikoni informacionin e disponueshëm vizual për etiketat.</i>  <i>* Verifikoni që informacioni i dhënë për etiketat është në gjuhën që punëtorët e kuptojnë (Shqip dhe Serbisht).</i> <i>* Shembuj të etiketave për substanca dhe përzierje kimike janë dhënë në Shtojcën 1 të kësaj liste kontrolluese.</i> <i>* Për të identifikuar se cilat etiketa duhet të përdoren, kërkon nga punëdhënësi Listat Teknike të Sigurisë (LTS) të substancave dhe përzierjeve kimike të përdorura / ruajtura. Krahasoni nëse etiketat në LTS janë të njëjta me ato që shfaqen në enë. Nëse nuk ka LTS të substancave dhe përzierjeve kimike, kërkojini ato nga furnizuesi, ose dyqani (kjo është pa pagesë).</i>			

	* Në të gjitha vendet ku kancerogjenët dhe/ose mutagjenët, përdoren, ruhen dhe asgjësohen, shenjat dhe etiketat duhet të vendosen afër zonës apo derës e cila dërgon në dhomën e punës dhe ruajtjes * Të gjithë të punësuarit që punojnë me substanca dhe përzierje me kancerogjenë dhe mutagjenë duhet të kuptojnë domethënien e piktogrameve dhe informacionin për etiketat. Kërkojuni atyre t'i shpjegojnë piktogramet në paketim në vendin e tyre aktual të punës. Nëse ata nuk i dinë, përfshijeni këtë temë në trajnimin e ardhshëm për SSHP. * Të gjithë të punësuarit që punojnë me substanca ose përzierje kancerogjene dhe/ose mutagjene duhet të jenë të trajnuar plotësisht dhe siç duhet para çdo trajtimi dhe përdorimi të substancave. <u>Shënim:</u> Një kimikat mund të ketë më shumë se një rrezik që shoqërohet me të! Prandaj, është e rëndësishme t'i regjistroni dhe t'i dini të gjitha rreziqet. Për shembull, acetoni është shumë i ndezshëm, një irritues i fortë në sy dhe shkakton përgjumje ose marramendje.			
3.	A janë të dukshme qartë për punëtorët etiketat në enët e kimikateve të përdorura për punë ose ruajtje? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 6.5.12, 6.5.13 Rregullore (MPMS) Nr.04/2016, Shtojca III, Pikat 1, 2, 5 Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Nenet 6, 10.1.2			
4.	A janë kimikatat në enët e duhura për përdorimin dhe ruajtjen e tyre (d.m.th. shishe, boca, kova, rezervuarë të ruajtjes etj.)? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 6.5.12, 6.5.13 Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Nenet 6.2.7, 10.1.2 Ligji Nr.04/L-197 për Kimikate, Neni 24 * Kontrolloni të gjitha vendet e punës ku përdoren kimikatat; kontrolloni për ndonjë rrjedhje. * Verifikoni nëse paketimi i kancerogjenëve dhe/ose mutagjenëve është i mbyllur mirë kur substanca ose përzierja nuk është në përdorim.			

	* Verifikoni nëse kimikatet nuk përdoren dhe ruhen në paketimin e përdorur zakonisht për ushqim, ushqim kafshësh, artikuj mjekësorë dhe kozmetikë. * Nëse të punësuarit i kullojnë ose transferojnë substancat nga ena e tyre origjinale në enë më të vogla për përdorim në vendin e punës, ose i përziejnë substancat në enë në vendin e punës për përdorimin e tyre, etiketat duhet të deklarojnë produktin ose emrin kimik dhe të përfshijnë një piktogram të rrezikut dhe deklaratë të rrezikut që pasqyron klasifikimin e substancës. * Nëse hasni në një vend të punës ku ndonjë i punësuar nuk i ndjek rregullat e trajtimit të sigurt të kimikateve, kushtojini menjëherë vëmendje gabimeve të tyre. Përfshini temën mbi punën e sigurt në trajnimin e ardhshëm për SSHP. Shënim: Kimikatet duhet të ruhen në enë origjinale. Nëse kimikatet nuk ruhen në enë origjinale, sigurohuni që enët e ruajtjes të jenë etiketuar në mënyrë të përshtatshme dhe të saktë. Materialet e rrezikshme ruhen vetëm në pako ose enë të mbyllura.			
5.	A janë vendosur shenja paralajmëruese dhe të sigurisë përfshirë “Ndalohej pirja e duhanit” në zonën ku përdoren kancerogjenët dhe/ose mutagjenët (p.sh., berilium, azbest)? A është e lehtë të lexohen? A janë shënjuar qartë zonat/detyrat e përcaktuara për përdorim të PPM-ve? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 6.5.10, 6.5.7, 6.5.9, 12,3 Rregullore (MPMS) Nr.04/2016			
6.	A janë trajnuar për punë me kancerogjenë dhe/ose mutagjenë të punësuarit që punojnë në zona të demarkuara? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 6.5.12, 6.5.13, 12 Të gjithë të punësuarit duhet të trajnohen, posaçërisht në lidhje me pikat e përcaktuara në rregulloret në fuqi: • Efektet shëndetësore të ekspozimit ndaj kancerogjeneve dhe/ose mutagjeneve në vendin e punës; • Mjetet e reduktimit të ekspozimit ndaj kancerogjeneve, nëse nuk mund të eliminohen; • Metodatat e punës së sigurt.			

	<i>Pyetni të paktën 2-3 të punësuar:</i> <i>* për çka, kur dhe pse duhet t'i përdorin PPM-të (p.sh. kur dhe pse duhet të përdorni dorëza, ose kur do të punoni me një kimikat të caktuar, çfarë dorëza do të përdorni, ku janë këto dorëza).</i> <i>* A e dinë kuptimin e piktogrameve në enët e kancerogjenëve dhe mutagjenëve? A dinë si ta pastrojnë vendin e punës? A mund ta shpjegojnë se çfarë lloj mjetesh përdorin për pastrim?</i> <i>Punëdhënësi duhet të sigurohet që të gjithë të punësuarit dinë të punojnë në mënyrë të sigurt dhe t'i trajtojnë kancerogjenët dhe/ose mutagjenët. Nëse ata nuk kanë njohuri për ndonjë arsye, trajnimi duhet të përsëritet.</i>			
7.	A janë pajisur të punësuarit me PPM adekuate dhe të përshtatshme? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 6.5.7 Rregullore (MPMS) Nr.02/2016, Neni 6.3.1, 6.3.2, 7.1.3 <i>* Nëse të punësuarit po transferojnë ose hollojnë kimikate me kancerogjenë dhe/ose mutagjenë, sigurohuni që syzet e sigurisë ose mbrojtja e fytyrës, dorezat dhe veshjet e përshtatshme mbrojtëse janë ofruar nga punëdhënësi dhe punëtorët i përdorin ato. Pyetni të gjithë të punësuarit që nuk i përdorin PPM-të, se cilat janë arsyet e mospërdorimit të PPM-ve?</i> <i>* Kontrolloni të paktën 2 lloje të PPM-ve të ndryshme, nëse janë të përshtatshme për punën që po bëhet (p.sh. nëse i punësuarit është i ekspozuar ndaj pluhurit, duhet të përdoren respiratorë me filtrat P2 ose P3; nëse i punësuarit është duke punuar me kimikate, kontrolloni nëse materiali i dorezave është mbrojtës ndaj grupit të veçantë kimik).</i> <i>Shënim: PPM-të kur punoni me kimikate përfshijnë, por pa kufizim, pantallona të gjera, përparëse, këpucë, doreza, gota rezistente kimike, mbrojtje të fytyrës dhe respiratorë.</i>			
8.	A janë të punësuarit të informuar/trajnuar pse duhet t'i përdorin PPM-të? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 11.1, 12.1 Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 10.1.3 <i>Pyesni të gjithë të punësuarit kur, pse dhe cilat PPM duhet të përdorin (p.sh. kur dhe pse duhet të përdorni dorëza, ose kur do të punoni me ndonjë kimikat, çfarë</i>			

	<i>dorëze do të vishni, ku janë këto dorëza). Nëse ata nuk janë të vetëdijshëm, përfshijeni këtë temë në trajnimin e ardhshëm për SSHP.</i>			
9.	A u kërkohet të punësuarve t'i lajnë duart, fytyrën, parakrahët dhe qafën para çdo dalje nga zona e demarkuar dhe të bëjnë dush në fund të ditës? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 6.5.12, 6.5.13, 11 <i>Pyetni të paktën 2-3 të punësuar që punojnë me kancerogjenë dhe/ose mutagjenë, sa shpesh i lajnë duart dhe fytyrën gjatë ditës së punës? Është një kërkesë e detyrueshme që të punësuarit të lajnë të paktën fytyrën dhe duart kur dalin nga zonat e demarkuara. Punëdhënësi është përgjegjës për sigurimin e ambienteve të përshtatshme.</i>			
10.	A u sigurohen të punësuarve veshje mbrojtëse për tërë trupin para se të hyjnë në zona të demarkuara? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 6.5.12, 6.5.13, 11. <i>Verifikoni nëse të gjithë punëtorët në zonat e demarkuara janë të pajisur me veshje mbrojtëse për tërë trupin.</i>			
11.	A i zhveshin të punësuarit veshjet mbrojtëse kur largohen nga zonat e demarkuara? Në fund të ditës, a i vendosin ato veshje në një kontejner të padepërtueshëm për dekontaminim ose asgjësim? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 6.5.12, 6.5.13, 11			
12.	A ofrohen vende të ndara të ruajtjes për veshjet e punës ose mbrojtëse dhe për veshjet normale? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Neni 11.1. 3 <i>Veshjet mbrojtëse të kontaminuara duhet të përdoren veçmas. Ato duhet të mblidhet në kontejner të caktuar me etiketa që përshkruajnë përmbajtjen si veshje të kontaminuar me substanca kancerogjene dhe/ose mutagjene. Nëse të punësuarit përdorin veshje të asgjësueshme, pas përdorimit ato duhet të trajtohen</i>			

	<i>si mbetje të rrezikshme. Të punësuarit nuk duhet të largojnë veshjet e kontaminuara jashtë vendeve të punës.</i>			
13.	A ruhen kancerogjenët dhe/ose mutagjenët e rrezikshëm në zona të ftohta dhe të ajrosura mirë veçmas nga kimikatet e tjera? A ka qasje të kufizuar për të punësuarit në zonën e depozitimit për kancerogjene dhe/ose mutagjenë të rrezikshëm? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 6.3, 6.5.12, 6.5. 13, 10 * <i>Kimikatet me veti kancerogjene dhe/ose mutagjene nuk duhet të ruhen kurrë brenda dhe përgjatë rrugëve të këmbësorëve dhe të kalimit, duke përfshirë shkallët, korridoret, daljet dhe rrugët emergjente, trotualet e ngushta dhe oborret brenda ndërtesës.</i> * <i>Dhomat e ruajtjes duhet të kenë një sistem ventilimi për të siguruar që nuk krijohen kushte të rrezikshme për të punësuarit gjatë operimit normal dhe në rast të ndonjë rrjedhje të produktit të parrezikshëm.</i> * <i>Duhet të sigurohet që te agentët kancerogjenë dhe mutagjenë mund të kenë qasje vetëm të punësuarit e trajnuar për teknika të punës së sigurt.</i> * <i>Verifikoni nëse zonat e ruajtjes kanë presion negativ në lidhje me zonat e parregulluara.</i>			
14.	A grumbullohen dhe largohen në mënyrë sistematike nga vendet e punës paketimet e zbrazëta të kimikateve të përdorura? A janë etiketuar si të tilla materialet e mbeturinave që përmbajnë kancerogjenë dhe mutagjenë? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 6.3, 6.5.3, 6.5.13 * <i>Verifikoni nëse paketimet e zbrazëta të kimikateve të përdorura grumbullohen në mënyrë sistematike (të paktën një herë në ditë) dhe largohen nga vendet e punës.</i> * <i>Shënim: Paketimet e përdorura dhe mbeturinat e kimikateve të rrezikshme duhet të asgjësohen në një zonë të veçantë për mbeturina të rrezikshme.</i>			
15.	A janë të disponueshme Listat Teknike të Sigurisë (LTS) dhe a kanë punëtorët qasje të lehtë në to?			

	Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Neni 13.1.4 Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 10 Rregullore EC RVAKK Nr.1907/2007, Neni 35 <i>* Të gjithë të punësuarit duhet të dinë se ku ruhen dokumentet e të dhënave të sigurisë dhe duhet të jenë në gjendje t'i lexojnë nëse është e nevojshme.</i> <i>* Të gjithë të punësuarit duhet të dinë se çfarë lloj informacioni mund të gjejnë në to.</i> <i>* Informacioni mbi rreziqet, ndihmën e parë, ruajtjen dhe trajtimin, PPM-të, duhet të përfshihet në udhëzim dhe të punësuarit duhet të trajnohen për këto tema.</i>			
16.	A ofrohen pajisje dhe mjete të nevojshme për përdorim të sigurt të kimikateve (p.sh. ventilatorë, pompa, mjete për mbledhjen e derdhjeve dhe rrjedhjeve të kimikateve)? Kur merren ose largohen pajisjet, materialet ose gjërat e tjera nga një zonë me kancerogjenë e rregulluar, a bëhet kjo në atë mënyrë që nuk kontaminohen zonat e parregulluara ose mjedisi i jashtëm? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Neni 6 <i>* Të gjithë të punësuarit e përfshirë në punën me kimikate duhet të dinë se ku ndodhen pajisjet e përshtatshme për t'iu përgjigjur fillimisht një incidenti kimik, për shembull materiali absorbues për të ndalur derdhjen e lëngjeve. Pyeti ata, nëse e dinë? Nëse nuk janë të vetëdijshëm, përfshijeni këtë temë në trajnimin e ardhshëm për SSHP.</i> Shënim: <i>* Pajisjet duhet të mbahen aty ku janë lehtësisht të arritshme për të gjithë punëtorët. Punëtorët duhet të dinë t'i përdorin për qëllimet e parapara.</i> <i>* Pajisjet nga zonat e kontaminuara nuk duhet të nxirren jashtë atyre zonave.</i> <i>* Pajisjet e sigurisë për përdorim me kimikate të rrezikshme duhet të jenë në përputhje me kimikatet e rrezikshme me të cilat mund të bien në kontakt. Për shembull, aparatet kundër zjarrit me ujë nuk duhet të përdoren në shuarjen e zjarreve të vajrave.</i>			
17.	A janë shënuar dhe a janë të disponueshme objektet e ndihmës së parë? Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 8			

	* Kontrolloni nëse mund t'i shihni shenjat e sigurisë për objektet e ndihmës së parë nga disa pika të lokacionit. Nëse nuk mund t'i shihni shenjat, pyesni 2-3 punëtorë se ku ndodhen objektet e ndihmës së parë. * Larja e syve dhe dushet janë në gjendje pune dhe lehtësisht të arritshme kur kërkohet.			
	 Dushi i sigurisë	 Pastrues për sy		
	INSPEKTIMI I DOKUMENTEVE NË ZYRË			
	* Nëse keni një ofrues të jashtëm të shërbimit të SSHP-së ose ekspertin tuaj për SSHP, takohuni me të/ata. * Ftoni përfaqësuesin e të punësuarve të marrë pjesë në kontrollimin e dokumenteve.			
18.	A e keni regjistruar numrin dhe emrat e të punësuarve potencialisht të ekspozuar ndaj kancerogjenëve dhe/ose mutagjenëve? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Neni 7			
19.	A i keni regjistruar sasi të substancave ose përzierjeve të prodhuara ose të përdorura që përmbajnë kancerogjenë ose mutagjenë? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Neni 7 Përgatitni listën e inventarit të kimikateve të rrezikshme.			
20.	A është përfshirë vlerësimi i riskut të substancave dhe përzierjeve kimike me kancerogjenë dhe mutagjenë të përdorura, në vlerësimin e riskut në vendin e punës? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 4, 7 * Kontrolloni dokumentin e vlerësimit të riskut për të identifikuar nëse substancat dhe përzierjet kimike vlerësohen veçmas për secilin proces teknologjik (p.sh, pastrim, saldim etj.).			

	* A vlerësohen kimikatet sipas rrugës së hyrjes në trup (p.sh., nga frymëmarrja, gëlltitja, thithja përmes lëkurës). Të gjitha rrugët e ekspozimit do të merren parasysh, diskutoni me ekspertin për SSHP. Shihni shembujt në Aneksin 2 të këtij dokumenti. * A keni përgatitur dhe a mbani një inventar të të gjitha substancave të rrezikshme të përdorura dhe të depozituara në kompaninë tuaj, përfshirë mbeturinat e rrezikshme? <u>Shënim:</u> Kur identifikoni rreziqet në vendin tuaj të punës, merrni parasysh: • sasinë e substancave të rrezikshme që keni në vendin e punës • çfarëdo rreziku fizik ose kimik i lidhur me reaksionet e mundshme me substanca të tjera • burimet e ndezjes • strukturat e impiantit ose sistemet e punës të përfshira në përdorimin, trajtimin, prodhimin ose ruajtjen e substancave • punën e kryer nga të punësuarit me substancën dhe rrezikun e tyre të ekspozimit dhe shkallën e mundshme të atij ekspozimi, dhe çdo standard të caktuar të ekspozimit ose interval të kufizuar të hyrjes për substancën			
21.	A është marrë parasysh informacioni i disponueshëm nga LTS-të për substancat dhe përzierjet me kancerogjenë dhe/ose mutagjenë, në vlerësimin e riskut në vendin e punës? A është përfshirë në udhëzimin për siguri në punë informacioni për përdorimin e sigurt të kancerogjenëve dhe mutagjenëve i paraqitur në LTS? Ligji Nr.04/L-197 për kimikatet, Neni 33 Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Neni 6 * Kontrolloni dokumentet, zgjidhni LTS të kancerogjenëve dhe mutagjenëve të përdorur gjerësisht në kompani, verifikoni nëse informacionet për p.sh. kufizimet ose/dhe kërkesat për trajtimin ose ruajtjen (seksioni 7 i LTS); kërkesat për ventilim, masat e sigurisë, PPM (seksioni 8 i LTS), përfshihen në udhëzimet e sigurisë në punë.			

	<i>* Nëse informacioni ndryshon ose nuk përfshin rreziqe të rëndësishme (p.sh., ju përdorni kancerogjenë dhe mutagjenë në proceset teknologjike, por udhëzimi shpjegon punën e sigurt vetëm me baza dhe acide), rishikoni dhe përmirësoni udhëzimet. Pas një rishikimi të udhëzimit, kryeni informim të përsëritur dhe trajnimin e të punësuarve.</i>			
22	A e keni vlerësuar mundësinë e zëvendësimit të substancave më pak të rrezikshme dhe/ose në zvogëlimin e sasive të përdorura? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Neni 5			
23.	A janë marrë masa për të zvogëluar dhe parandaluar rreziqet kimike? A keni vlerësuar nëse rreziqet mund të shmangen ose të reduktohen në mënyrë të mjaftueshme nga mjetet teknike të mbrojtjes kolektive ose nga masat, metodat ose procedurat e organizimit të punës? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Nenet 5, 6, 11 <i>Kontrolloni dokumentin e vlerësimit të riskut për të identifikuar nëse mund të zbatohen masa të tjera parandaluese, diskutoni me ekspertin për SSHP.</i> <i>Verifikoni:</i> <i>* a ekzistojnë procedura për situata të mundshme emergjente?</i> <i>* a ka pajisje emergjente që mund të kërkohen në vendin e punës (p.sh., materiali absorbues i përshtatshëm për kimikatet që mund të derdhen; aparatet kundër zjarrit; agjentët neutralizues; pompa dhe gypa të përshtatshëm për largimin e materialit të derdhur; kutitë e ndihmës së parë; dushet e emergjencës dhe stacionet e larjes së syve; vegla dore të tilla si leckë, kova, shtrydhëse dhe kosha; veshje dhe pajisje mbrojtëse të përshtatshme për të mbrojtur sigurinë dhe shëndetin e personelit të përfshirë në pastrim)?</i> <i>* a ka shenja të duhura sigurie në vendet e punës nëse është e nevojshme?</i> <i>* a ka ventilim shkarkues (aspiratorë) nëse është i nevojshëm (a mirëmbahet rregullisht)?</i> <i>* a kryhet pastrimi i rregullt i dyshemesë, mureve dhe sipërfaqeve të tjera?</i> <i>* a keni procedura të shkruara të dekontaminimit dhe pastrimit për të gjithë kancerogjenët e asgjësuar si mbeturina të rrezikshme?</i>			


24.	A i përfshijnë shënimet e trajnimit efektet shëndetësore, kontrollet, metodat e sigurta të punës dhe pajisjet/veshjet personale mbrojtëse? Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 10			
25.	A janë të trajnuar të punësuarit për rreziqet e trajtimit dhe përdorimit të kancerogjenëve dhe/ose mutagjenëve? Rregullore (MPMS) Nr.10/2017, Neni 10 <i>Kontrolloni dokumentet.</i> <i>Verifikoni në bazë të të gjitha informacioneve në dispozicion, nëse të punësuarit janë të trajnuar dhe udhëzimet e sigurisë përfshijnë sa vijon:</i> • rreziqet e mundshme për shëndetin, përfshirë rreziqet shitesë për shkak të konsumit të duhanit; • masat për të parandaluar ekspozimin; • kërkesat e higjienës; • përdorimin e pajisjeve dhe veshjeve mbrojtëse; • hapat që duhen ndërmarrë nga të punësuarit, përfshirë të punësuarit e shpëtimit, për të parandaluar incidentet dhe në rast incidentesh.			
26.	A janë kryer matje të kimikateve me kancerogjenë dhe mutagjenë në ajrin e vendit të punës? A janë krahasuar rezultatet me vlerat kufitare të ekspozimit në punë? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Neni 6.4, Shtojca 3 <i>Identifikoni vendet e punës ku mund të shfaqen tymi, pluhuri dhe avuj të substancave kancerogjene dhe/ose mutagjene gjatë procesit të punës. Planifikoni të organizoni matje laboratorike.</i> <i>Krahasoni rezultatet e matjeve me vlerat kufitare të ekspozimit në punë të specifikuar në legjislacion.</i>			
27.	A dërgohen të punësuarit në kontrolle shëndetësore në intervale të rregullta? Rregullore (MPMS) Nr.04/2017, Neni 15			

	<i>Kontrolloni dokumentet. Kontrolli fillestar mjekësor i të punësuarve duhet të bëhet menjëherë pas punësimit. Kontrolli tjetër shëndetësor duhet të bëhet përputhje me nivelit e rrezikut të kimikateve, kohëzgjatjen dhe nivelin e ekspozimit dhe shkallën e riskut.</i>			
	PAS VETË-VLERËSIMIT			
	* Diskutoni me menaxhmentin e lartë për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për përmirësimet e nevojshme * Diskutoni me menaxherët e nivelit të mesëm të lokacionit/vendit të punës së vizituar për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për përmirësimet * Në rast se keni një ofrues të jashtëm të shërbimit të SSHP-së ose ekspert të SSHP-së, diskutoni me të për vëzhgimet dhe konkluzionet tuaja për përmirësimet Zbatoni masat e nevojshme të kontrollit të identifikuar gjatë vetë-vlerësimit.			

Shtojca 1

	Komente
--	---------

Chemical name and product identifier Acetone EC No. 200-662-2 ABC Chemicals Main Street Anytown Tel. 0123 456 789 Name, address and telephone number of supplier Danger Highly flammable liquid and vapour. Causes serious eye irritation. May cause drowsiness or dizziness. Keep away from heat / sparks / open flames / hot surfaces – No smoking. Avoid breathing vapours. Wear protective gloves / eye protection. IF IN EYES: Rinse cautiously with water for several minutes. Remove contact lenses, if present and easy to do. Continue rinsing. Store in a well-ventilated place. Keep container tightly closed. Signal word Hazard and precautionary statements Repeated exposure may cause skin dryness and cracking. 500 ml Nominal quantity Pictograms Supplementary information	Shembulli i etiketës për substanca
Trade name SuperClean Use instructions Apply to surfaces using a damp cloth Warning Causes serious eye irritation. Keep out of reach of children. Wear protective gloves / face protection. IF IN EYES: Rinse cautiously with water for several minutes. Remove contact lenses, if present and easy to do. Continue rinsing. Contains Anionic surfactant <5%. Signal word Hazard and precautionary statements Super Cleaning Company New Works, Factory Road Anytown Tel. 0987 654 321 Name, address and telephone number of supplier Identity of hazardous components 500 ml e Nominal quantity Pictograms	Shembulli i etiketës për përzierje



Shtojca 2 Kancerogjenët

Ne mund të jemi të ekspozuar ndaj kancerogjenëve në pluhur, lëng, gaz, valë apo forma të tjera. Mund të jenë pa ngjyrë, pa erë dhe të padukshme. Shihni tabelën më poshtë për shembuj.

RRUGËT E HYRJES NË TRUP	SHEMBUJ	MJETET E PARANDALIMIT
Frymëmarrja	Pluhur druri	Ventilimi lokal i shkarkimit Mbrojtja e frymëmarrjes
	Pluhur silikat në përbërjen e murit	Ventilimi lokal i shkarkimit Metodat e punës Mbrojtja e frymëmarrjes
	Fijet e asbestit në materialet e trajtuara	Metodat e punës Veshje mbrojtëse Mbrojtja e frymëmarrjes Higjiena personale
	Gazrat nga zhveshja e mobiljeve	Zëvendësimi Ventilimi lokal i shkarkimit Metodat e punës Mbrojtja e frymëmarrjes Doreza të përshtatshme
	Shkarkim i motorit diesel	Mirëmbajtja mekanike Ventilimi lokal i shkarkimit Ventilimi i përgjithshëm
	Pluhuri dhe tymi gjatë veshjes së metaleve	Ventilimi lokal i shkarkimit Metodat e punës Mbrojtja e frymëmarrjes Doreza të përshtatshme
Thithja përmes lëkurës	Tretësit që përdoren për pastrim	Zëvendësimi Metodat e punës Doreza të përshtatshme
Kontakti me lëkurën	Kontakti i duarve me katran ose blozë	Metodat e punës Doreza të përshtatshme

		Higjiena personale
Gëlltitja	Mbajtja e ushqimit ose cigares me duar të papastra	Metodat e punës Higjiena personale